

BASHKIA VAU DEJËS
NJOFTIM PËR DHËNIEN ME QIRA

1.Fillimi i procedurave për dhënie me qira me anë të konkurimit te sipërfaqes se fondit Pyjor/kullosor publik sipas udhëzimit nr.1,datë 09.06.2016” Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave Për Dhënie Në Përdorim të Fondit Pyjor Dhe Kullosor Publik”: që i përket ekonomisë Pyjore Drin Gjadër kirë,ngastra nr. 4, Loti I në sipërfaqe prej 12.0373 ha “Për park fotovoltai”, (stacionet,Bazamentet dhe objektet përkatëse etj)” me afat përdorimi (qiraje), 10(dhjetë) vite.

2.Çmimi dysheme i fillimit të konkurimit është 143,000 leke/ha vit dhe per 12.0373 ha është 1,721,333.9 lekë në vit në sipërfaqe djerre/ranishte , e përllogaritur kjo sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”.

3. Qëllimi i përdorimit është dhënia në gëzim të përkohshëm të sipërfaqes pyjore “Për park fotovoltai”, (stacionet,Bazamentet dhe objektet përkatëse etj)”.

5. Pikët vlerësuese sipas kriterëve te konkurimit për subjektet që konkurojne do të jenë :

| Nr . | Lloji i Kriterit | Pesha e matur në pike e kriterit vlerësues(e shprehur në pikë) |
|------|---|--|
| 1 | Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10 000 ku të | 20 |

| | | |
|---|---|----|
| | jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit | |
| 2 | planbiznesi dhe investimet që do të bëhen | 15 |
| 3 | planin e rehabilitimit të sipërfaqes | 25 |
| 4 | nivelin e punësimit në veprimtari | 5 |
| 5 | masën e qirasë për lek/ha/vit | 35 |

6. Dokumentacioni që duhet të plotësohet nga konkurrentët për konkurrim është:

Personat fizik dhe juridik që marrin pjesë në konkurrim duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
- ekstraktin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë;
- projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;
- planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
- të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
- nivelin e punësimit në veprimtari;
- lejen mjedisore për aktivitetin e kërkuar/vlerësim i ndikimit në mjedis paraprak(VNM)
- çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
- adresën e subjektit, telefon, email, dhe faks.

7. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurim janë:

- garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes;
- të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë;
- vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

8. Vendi i zhvillimit të konkurimit: (Adresa:) Zyra Drejtorise së Pyjeve ,Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Bashkia Vau Dejës.

9. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: me date 22.05.2023 ,ora 12.00

10. Informacion mbi dokumentet e ankandit/konkurimit:

Dokumentet e ankandit/konkurimit mund të terhiqen pranë autoritetit shites

Dokumente me pagesë:

Po X Jo

Nëse Po

Monedha leke Çmimi 1500

Dokumentet standarde të ankandit/konkurimit përbehen nga:

- Formulari i njoftimit;

- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për oferte;
- Formulari i njoftimit të fituesit;
- Formulari i publikimit të njoftimit të fituesit;
- Procesverbali/et i/e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

11. Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës në kopje fizike, me poste ose dorazi, në vendin e përcaktuar në dokumentet e konkurimit .